

EXISTENTIALISM ACCORDING TO FRENCH PHILOSOPHY AND LITERATURE

EKZISTENCIALIZMI SIPAS FILOZOFISË DHE LETËRSISË FRËNGE

Dëfrim SALIU¹, Shejnaze AJDINI-MURTEZI², Besa SALIU³

^{1*} Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

³ Gymnasium „Kiril Pejçinoviç“ – Tetovo

*Corresponding author e-mail: defrim.saliu@unite.edu.mk

Abstrakt

In the first years after the Second World War in the countries of Western Europe, primarily in France, the philosophical and literary movement - existentialism - began to expand and spread rapidly. This movement directly marks its successes and greatest popularity at this time. Today, existentialism is undoubtedly one of the most widespread philosophical and literary trends that exerted a great influence on scientific circles, in the field of philosophy and literature.

When discussing the issues of existentialist philosophy, the socio-historical conditions that enabled the emergence and development of this philosophy in the West are highlighted. Existentialism in intellectual philosophical and literary circles in the West was fashionable and in a way expressed the agitation of the ideologists of this society towards the democratic forces that had developed. This philosophy, for its own interests, is individualistic and has a pessimistic content. Thus, the existentialist seeks in every way a way out of his own life situation. The only way out of this situation he sees in absolute freedom. But, if the existence of the material world and objective-social laws is accepted, that freedom is incomprehensible. For this reason, existentialists abandon materialism in the name of phenomenological materialism and rationalism in the name of irrationalism.

Keywords: Existentialism, philosophy, French literature, Camus, Sartre.

Përmbledhje

Në vitet e para të pas Luftës së Dytë Botërore në vendet e Europës Perëndimore, në radhë të parë në Francë, me të madhe filloi të zgjerohet dhe të përhapet lëvizja filozofike letrare - ekzistencializmi. Sukseset e veta dhe popullaritetin më të madh kjo lëvizje e shënon drejtpërdrejt në këtë kohë. Sot, ekzistencializmi pa dyshim është ndër drejtimet filozofike-letrare më të përhapura që ushtroi ndikim të madh në qarqet shkencore, në lëmin e filozofisë dhe letërsisë.

Kur flitet mbi çështjet e filozofisë ekzistencialiste, vihen në pah kushtet shoqërore-historike që kanë mundësuar shfaqjen dhe zhvillimin e kësaj filozofie në Perëndim. Ekzistencializmi në qarqet intelektuale filozofike dhe letrare në Perëndim ishte në modë dhe në një mënyrë shprehte trazimin e ideologëve të kësaj shoqërie ndaj forcave demokratike të cilat ishin zhvilluar. Kjo filozofi, për interesat e veta është individualiste dhe ka brendi pesimiste. Kështu, ekzistencialisti kërkon në çdo mënyrë shtegdalje prej situatës së vetë jetësore. Të vetmen rrugëdalje prej kësaj situatë ai sheh në lirinë absolute. Por, nëse pranohet ekzistenca e botës materiale dhe ligjësitë objektive-shoqërore, ajo liri është e pakuptueshme. Për këtë arsye ekzistencialistët e braktisin materializmin në emër të materializmit fenomenologjik dhe racionalizmin në emër të irracionalizmit.

Fjalët kyçe: Ekzistencializmi, filozofi, letërsi frënge, Camus, Sartre.

Hyrje

Ekzistencializmi si doktrinë klasike me racionalizmat e tij deri në një periudhë të caktuar, nuk ka qenë në gjendje që në pikëpamje ideore të ndriçojë situatën jetësore të individit në këtë ambient social. Situata jetësore praktike e kësaj shtrese të inteligjencies domosdo ka kërkuar në filozofi zgjidhjen e problemit të vet. Shfaqjen dhe zhvillimin e filozofisë ekzistencialiste nuk duhet kërkuar vetëm në periudhën pas Luftës së Parë ose të Dytë Botërore.¹²

Në këtë kohë dalin në shesh veprat filozofike-letrare që u përhapën dhe patën ndikim të madh, siç janë veprat e Martin Heidegger-it, Karl Jaspers-it, Jean-Paul Sartre-it, etj. Në fakt, kjo duhet kuptuar si varantë e filozofisë idealiste, e cila si burim absolut e kishte subjektivitetin, duke mohuar ligjshmërinë e shoqërisë dhe duke konsideruar se vetëdija shoqërore nuk e ka shkakun e vet të brendshëm. Gjëja më specifike që theksohet në mënyrë të dukshme prej ekzistencializmit është se njeriu si individ ndodhet i veçuar prej bashkësisë, te ai nuk ndikon ambienti, por është krejtësisht i lirë në vendimet e tij.

Ç'është ekzistencializmi?

Ekzistencializmi orvatet t'i afrohet njëmendësisë, problemeve e njeriut në jetën e tij të rëndomtë. Si i tillë, ekzistencializmi është filozofi idealiste e njeriut vetjak, kundër filozofisë së shoqërisë dhe njeriut shoqëror dhe është në kundërshtim me konceptin bashkëkohor të botës fizike. Filozofia ekzistencialiste përpiket që të vërtetën mbi njëmendësinë ta kuptojë si realizim të subjektit të vetënjohjes, por mbetet në pozitat negative-kritike. Për ndryshim prej filozofisë antropologjike, e cila njeriun e konsideron si *qenie midis qenieve*, filozofia e ekzistencës e shpie qenien e njeriut përherë në lidhje të vendosur me *esse essentiae et existentiae*, me qenien e cila si e tillë shfaqet në fushëveprimin e ekzistencës njerëzore.¹³

Për këtë shkak të ekzistosh nuk do të thotë thjesht të jesh aty, siç ekziston të themi guri, por të ekzistosh do të thotë edhe më shumë se çdo qenie tjetër, sepse qenia e njeriut e përfshin raportin e kundër vetvetes. E domosdoshme është në rradhë të parë, të jepen disa sqarime përkitazi me nocionin *ekzistencë*. Së pari, ekzistenca si qenie e veçantë, përfundimtare e ekzistencës së individit shoqëror, i paraprin esencës njerëzore (Sartre), ose ekzistenca përherë transcendohet vetëqenie (Heidegger).¹⁴

Nocioni i ekzistencës e ka domethënien e vet nëse çdo njeri është qenie e veçantë individuale, e cila nuk ekziston pa veçoritë e përgjithshme, të pjesëshme dhe të veçanta. Në kuptimin tekstual *ekzistencia* (lat. *existentia* - të qenurit e një gjëje; greq. *to on*; gjerm. *da - sein*; frëngj. *existence, etre - la*). Ose *ekzistenciale* është ajo që i përket strukturës fundamentale, ontologjike të ekzistencës, p.sh. të kuptuarit, qenia në botë, frika, brengat, rënia etj. Në filozofinë ekzistenciale, ekzistenca është një mënyrë e veçantë e qenies njerëzore.

Vetë termi në kuptimin e ngushtë është përdorur për herë të parë në vitin 1928 nga Fritz Heinemann-i, i cili ishte angazhuar me problematikën e vetë caktimit të ekzistencës së papërsëritshme të njeriut. Sartre-i në veprën e tij *Ekzistencializmi është humanizëm* thotë: „Atë që ata (Jaspers-i, Marcel-i, Heidegger-i dhe vetë Sartre-i) e kanë të përbashkët, është vetë fakti që kundrojnë se ekzistenca i paraprin esencës“.¹⁵

Mirëpo, me domethënien e kësaj fjale nuk pajtohen të gjithë ekzistencialistët. Sipas disave, si Martin Heidegger-it, *ekzistenca* është forca subjektive e njeriut, që varet prej vendimit të tij krejtësisht të lirë për të caktuar se si të jetë: *trim* apo *frikacak*, *me moral* apo *pa moral* dhe *si do ta ketë natyrën e tij*. Të tjerët nuk pajtohen me këtë përkufizim.

¹² Emmanuel Mounier, *Introduction aux existentialismes*, Gallimard, Paris, 1962, f. 23.

¹³ Yves Stalloni, *Écoles et courants littéraires*, Armand Colin, Paris, 2015, f. 167.

¹⁴ Ali Dida, *Kuptimi shoqëror i ekzistencializmit*, Jehona nr. 5, Shkup, 1974, f. 51.

¹⁵ Jean-Paul Sartre, *Ekzistencializmi është humanizëm*, Phoenix, Tiranë, 1997, f. 26.

Kështu Sartre-i duke ardhur në kundërshtim me qëndrimin e vet të përgjithshëm *që vetëm njeriut i takon ekzistenca*, thotë se ekzistencën nuk mund ta kuptojmë dhe ta caktojmë me ndërmjetësinë e arsyes. Protagonisti kryesor i romanit të tij, *Neveria*, Roquentin-i, fjala vjen, duke menduar mbi rrënjët e një druri që vë re në park, kupton se edhe rrënja e ka ekzistencën e vet. Ndërsa sipas Heidegger-it, ekzistenca e njeriut mund të përshkruhet dhe të vërehet. Ai e studion këtë me një metodë të veçantë. Pra, megjithëse nuk pajtohen njëri me tjetrin, në esencë, ekzistencialistët kanë ngjashmëri të madhe ndërmjet tyre. Ecuria e ndryshueshme e tyre rezulton nga fakti se njeriu nuk është krejtësisht qenie e lirë që *cakton çka të bëjë*, pavarësisht rrethanave të ndryshme, si e kuptojnë ekzistencialistët.¹⁶

Njeriu, në të vërtetë është individ me strukturë fizike. Ai i ka vetitë individuale, me të cilat edhe dallohet prej të tjerëve. Ai, si i tillë, me veçori të veta personale dhe shoqërore nuk është automat, por ndryshon prej të gjitha qenieve të tjera, si qenie sociale që është. Sipas ekzistencialistëve, shoqëria nuk ekziston, por ekziston vetëm individi i veçuar, i cili është i përcaktuar të jetë i lirë, meqë qysh para se të lindë zgjedh se çka për të qenë. Andaj teza kryesore e ekzistencialistëve, logjikisht nuk mund të formulohet dhe si e tillë është pa vend.¹⁷

Ndarja e ekzistencializmit

Si çdo rrymë apo shkollë filozofike, ashtu edhe ekzistencializmi lind në kushte të veçanta shoqërore, të cilat edhe i pasqyron. Kështu ai lindi në krizën shoqërore, që me vete sjell mossigurinë, dekadencën dhe luhatjen e shoqërisë. Në këto situata shfaqet ekzistencializmi, i cili me çdo kusht orvatet që në këtë filozofi të sintetizojë dy drejtime dominuese në tërë historinë e mendimit filozofik, materializmin dhe idealizmin, me qëllim që të formojë një filozofi të tërë *originale*, të përhershme - *universale*. Andaj, nuk është e rastit, siç u vu në pah, që çështja kryesore në këtë filozofi është njeriu si individ vetiak. Njeriu, sipas tyre është i gjykuar të zgjedhë dhe të vendosë Sipas tyre shoqëria e kufizon lirinë e vërtetë të individit. Njeriu tjetër, thotë Sartre-i, *nuk është miku im, sepse ai mua ma rrëmben lirinë dhe të gjithë atë që kam krijuar*.¹⁸

Këtu shihet se ekzistencialistët e kuptojnë njeriun si një qenie të izoluar, e cila kujdeset vetë për vete, kurse shoqëria ka qëndrim armiqësor ndaj tij. Filozofi për ta plotësuar mungesën e lirisë së vërtetë, krijon iluzione në gjuhën e vet abstrakte mbi lirinë absolute vetiake. Kur është fjala për zanafillën e ekzistencializmit, duhet theksuar se këtij drejtimi filozofik i takojnë disa përfaqësues si: Søren Kierkegaard, Karl Jaspers, Martin Heidegger, Gabriel Marcel, Jean-Paul Sartre, Albert Camus, Maurice-Merleau Ponty, Nicola Abbagnano, Nikolaj Berdjaev, Lev Shestov, etj. Me filozofinë ekzistencialiste të afërt janë edhe teologët ekzistencialistë si Martin Buber, Franz Rosenzweig, Rudolf Bultmann, Karl Barth, pastaj shkrimtarët Ernst Jünger, Rainer Maria Rilke, Franc Kafka, etj.¹⁹

Autori i personalizmit ekzistencial Emmanuel Mounier, ka konstruktuar drurin gjeneologjik të ekzistencializmit: rrënjët e drurit i përbëjnë stoikët, Sokrati, Augustini, trugun e përbëjnë Bertrand Russell, Maine de Biran dhe Søren Kierkegaard, prej të cilit ndahen dy degë: njërën e përbën Maurice Blondel, Henri-Louis Bergson, Max Ferdinand Scheler, Karl Jaspers, Nikolaj Berdjaev, Gabriel Marcel dhe të tjerë, ndërsa dega tjetër është më e shkurtër: Martin Heidegger, Jean-Paul Sartre, etj.²⁰

Jean-Paul Sartre-i në studimin e tij *Ekzistencializmi është humanizëm*, që konsiderohet deri diku si manifesti filozofik i Sartre-it, ekzistencialistët i ndan në dy grupe: në ekzistencialistë *krishterë*, të cilët si burim të tyre e kanë danezin Søren Kierkegaard, pastaj Karl Jaspers, Gabriel

¹⁶ Jean-Paul Sartre, *Neveria*, Fan Noli, Tiranë, 2014, f. 27.

¹⁷ Yves Stalloni, *Écoles et courants littéraires*, Armand Colin, Paris, 2015, f. 168.

¹⁸ Jean-Paul Sartre, *Ekzistencializmi është humanizëm*, Phoenix, Tiranë, 1997, f. 15.

¹⁹ Yves Stalloni, *Écoles et courants littéraires*, Armand Colin, Paris, 2015, f. 169.

²⁰ Emmanuel Mounier, *Introduction aux existentialismes*, Gallimard, Paris, 1962, f. 33.

Marcel dhe në *ateistë*, ku Sartre-i e vë vetëm Martin Heidegger. Kuptohet se një klasifikim i këtillë, siç është ky i Sartre-it, ka të meta, meqë nuk ka përfshirë edhe emra të tjerë, pikëpamjet e të cilëve janë ekzistencialiste.²¹

Filozofia ekzistencialiste

Filozofinë e ekzistencës duhet shikuar në suazat e zhvillimit të filozofisë, e cila fillon me René Decartes-in, vazhdon me Emmanuel Kant-in dhe idealizmin gjerman, deri te filozofia e jetës, fenomenologjia dhe filozofia antropologjike. Edhe pse filozofia ekzistencialiste nuk paraqet një sistem tërësor të pikëpamjeve, ekzistojnë disa probleme bazore, zgjidhja e të cilave përbën në mënyrë të caktuar brendinë tërësore të të gjithë ekzistencialistëve, pikëpamjet e të cilëve, përndryshe paraqesin një laramani të drejtë dhe shumë herë ndërmjet tyre janë kontradiktore.

Problem kryesor i filozofisë ekzistencialiste është individi, jeta dhe kuptimi i jetës së tij e jo natyra, jo jeta shoqërore dhe njeriu social. Prej kësaj shihet, në bazë të pikënisjes, se ajo është filozofi e jetës së njeriut, e jo edhe filozofi mbi natyrën ose botën, filozofi e ekzistencës e jo e esencës, pra ekzistenca e njeriut është problem kryesor. Përndryshe qenia është ajo që ekziston, ajo për të cilën mund të flitet, në një mënyrë ajo që *është* dhe çkado do të *jetë*. Çdo qenie duhet të jetë, patjetër, si diçka e caktuar. Ajo është kategori filozofike, që do të thotë çdo gjë që është tërësia e të gjitha objekteve reale dhe ideale të eksperiencës.

Sipas fenomeneve të transcendencës qenia njerëzore tregohet në të njëjtën kohë si *faktike* dhe si *transcendencë*. Të gjitha çështjet filozofike që në fund kërkojnë qenien rrjedhin prej situatave kufitare, me të cilat ndeshemi kudo. Puna e rëndomtë dhe e marrjes me qeniet, vetëdija mbi ato, shkenca etj., supozohen si mënyra të produktionit, të përshkruarit të strukturës formale të ekzistencës së njeriut, në fakt ajo që quhet *qenia e njeriut*. Çështja e qenies së njeriut, sa do e gjerë që është, sajohet si çështje e rëndësishme në filozofinë bashkëkohore.

Situatën, që njeriu është në raport kundrejt qenies, Sartre-i e ka interpretuar si *asgjësim* (néantissement) të vetë njeriut. Meqë vetëdija i shërben si paradigmë raporteve kundrejt qenies, ndërsa është në kundërshtim me qenien, Sartre-i atë e konsideron si *conscience* ose *pour - soi* si *le néant*. Sipas Sartre-it, njeriu nuk është mekanizëm i përsosur. Ai nuk është vetëm ai që ka për të qenë, por edhe ajo çka ka qenë e çka është tani.²²

Kjo tani në vete duhet të përfshijë edhe të kaluarën dhe të ardhmen: e kaluara e ka kuptimin e vet nëse i ka gjurmët, ardhmëria përherë është para nesh. Mund të thuhet që e kaluara nuk vendos gjer në konsekuencat e fundit zgjedhjen tonë. Njerëzit nuk e zgjedhin në kushte të caktuara, por në kushtet të cilat janë të trashëguara prej së kaluarës. Me fjalë të tjera, njeriu sipas raportit të vet të kundërqenies ndryshon mënyrën e ekzistencës së qenies. Ekzistenca e ka kuptimin e vet nëse çdo njeri është një qenie individuale.²³

Liria sipas ekzistencialistëve

Problemi i lirisë paraqet jo vetëm çështjen e mundësive psikologjike të njeriut, plotësisht të lirë dhe zgjedhjes spontane, por edhe si çështje e sendërtimit të mundësive, duke pasur parasysh ekzistencën e njerëzve të tjerë. Ekzistencializmi me qëndrimet e veta të para mbi lirinë absolute të njeriut, në spontanitetin e veprimtarisë njerëzore, e gjen qëndrimin e vet kryesor stoik dhe idealizmin historik në tërësi. Me qëndrimet e veta të tjera mbi lirinë, ekzistencializmi përsërit parimin kryesor të skepticizmit mbi forcën e vetëdijes që të gjejë një sistem mendor në botën e përvojave.²⁴

²¹ Ali Dida, *Kuptimi shoqëror i ekzistencializmit*, Jehona nr. 5, Shkup, 1974, f. 50.

²² Emmanuel Mounier, *Malraux, Camus, Sartre, Bernanos - L'espoir des désespérés*, Seuil, Paris, 1953, f. 55.

²³ Ali Dida, *Kuptimi shoqëror i ekzistencializmit*, Jehona nr. 5, Shkup, 1974, f. 54.

²⁴ Emmanuel Mounier, *Introduction aux existentialismes*, Gallimard, Paris, 1962, f. 14.

Andaj, nuk është e rastit që kjo filozofi thekson se qëllimi kryesor i jetës së njeriut është liria. Ekzistencialisti e bën këtë meqë njeriu sot, në kohën bashkëkohore ballafaqohet me domosdoshmëri të ndryshme e të shumta dhe ai është i zhveshur prej lirive themelore njerëzore. Ekzistencializmi nuk është në gjendje ta kuptojë në mënyrë praktikë-materialistike njeriun, jetën e as lirinë e tij.²⁵

Liria e personaliteteve të Sartre-it nuk paraqet begatinë, por varfërinë e qenies, mungesën e saj. Njeriu është i detyruar të përvetësojë përgjegjësitë për aksionet e veta, sepse ai është absolutisht i lirë. Ekzistencialistët injorojnë ligjësinë objektive-historike të zhvillimit të shoqërisë dhe mendojnë që vetëm në bazë të subjekteve të veçanta dhe të ekzistencës së tyre, mund të shpjegohet liria e vërtetë e njeriut. Sartre-i ka parë ligjësinë objektive shoqërore vetëm në aspektin e shtrembërruar të ideologjisë, si projekt të subjektit të esencës së tij.

Përfundimi

Ekzistencializmi mund të kuptohet më mirë me analizën e pikëpamjeve më kryesore të përfaqësuesve më të spikatur. Duke mos dhënë përgjigje për çështjet mbi vetë esencën e njeriut, filozofët ekzistencialistë nuk janë në gjendje që në mënyrë reale të paraqesin idetë e veta mbi zgjedhjen e lirë dhe mbi angazhimin, kështu duke e proklamuar atë pa perspektivë dhe izolacion absolut të subjektit, i cili e ndjen lirinë si barrë dhe e injoron caktimin fundamental të njeriut si individ social. Pra, këtu qëndron njëri ndër iluzionet më kryesore të tij.²⁶

Nga ana tjetër, ai deri diku, ka vënë në pah anën e veprimtarisë subjektive të lirisë së njeriut, pa të cilën gjithashtu nuk mund të ketë liri, si krijim subjektiv njerëzor të domosdoshmërisë objektive historike. Aty është pjesa e së vërtetës e ekzistencializmit, që sipas Sartre-it, qorrsoakaku ekzistencialist dhe toni pesimist i humanizmit të tyre shfaqet mu për arsye se ata nisen prej zgjedhjes dhe projektimit të lirë të ekzistencës së veçantë.²⁷

Referencat

- [1]. Berisha, B. (2016). *Filozofimi midis logjikës dhe absurdit*, Tetovë: Çabej.
- [2]. Breisach, E. (1962). *Introduction to Modern Existentialism*, New York: Grove Press.
- [3]. Dida, A. (1974). *Kuptimi shoqëror i ekzistencializmit*, Shkup: Jehona nr. 5.
- [4]. Kaufmann, W. (2011). *Ekzistencializmi nga Dostojevski te Sartri*, Tiranë: Plejad.
- [5]. Lévy, B.-H. (2000). *Le Siècle de Sartre*, Paris: Grasset.
- [6]. Mounier, E. (1953). *Malraux, Camus, Sartre, Bernanos - L'espoir des désespérés*, Paris: Seuil.
- [7]. Mounier, E. (1962). *Introduction aux existentialismes*, Paris: Gallimard.
- [8]. Sartre, J.-P. (1997). *Ekzistencializmi është humanizëm*, Tiranë: Phoenix.
- [9]. Sartre, J.-P. (2014). *Neveria*, Tiranë: Fan Noli.
- [10]. Shabani, E. (2017). *Studime letrare*, Tetovë: Arbëria Design.
- [11]. Stalloni, Y. (2015). *Écoles et courants littéraires*, Paris: Armand Colin.
- [12]. Старова, Л. (1979). *Литература и ангажман*, Скопје: Мисла.
- [13]. Visoka, A. (2011). *Koha e shkrimit*, Prishtinë: 99-AIKD.

²⁵ Bernard-Henri Lévy, *Le Siècle de Sartre*, Grasset, Paris, 2000, f. 123.

²⁶ Ali Dida, *Kuptimi shoqëror i ekzistencializmit*, Jehona nr. 5, Shkup, 1974, f. 55.

²⁷ Beqir Berisha, *Filozofimi midis logjikës dhe absurdit*, Çabej, Tetovë, 2016, f. 136.